

EPPC Albania po kërkon një **HR Communications Specialist** për t'iu bashkuar ekipit.

Përgjegjësitë kryesore:

Menaxhimi i Komunikimeve Dixhitale dhe Promovimi i Shërbimeve të Kompanisë:

- Zhvillimi dhe implementimi i kalendarit mujor të komunikimeve dhe fushatave promovuese, në përputhje me prioritetet e biznesit;
- Krijimi i përmbajtjeve kreative, të strukturuar dhe me ndikim për të gjitha platformat sociale (LinkedIn, Instagram, Facebook, etj.);
- Hartimi dhe redaktimi i artikujve, blegeve, buletineve dhe materialeve të tjera të marketingut;
- Menaxhimi dhe përditësimi i përmbajtjes së faqes së internetit të kompanisë;
- Monitorimi i performancës së publikimeve/fushatave, dhe përgatitja e raporteve të përmbledhura, duke sugjeruar përmirësime bazuar në analizat e të dhënave.

Angazhim në projekte të HR dhe Learning & Development:

- Administrimi dhe mirëmbajtja e sistemit FinxS për vlerësimet e sjelljes, duke koordinuar përdorimin e tij si për nevojat e brendshme të stafit, ashtu edhe për klientët;
- Suport në planifikimin, organizimin logjistik dhe promovimin e aktiviteteve të team building dhe sesioneve të trajnimit;
- Asistim në përgatitjen e materialeve të komunikimit dhe marketingut për trajnime apo projekte të brendshme.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë Universitare në Marketing, Administrim Biznesi ose fusha të ngjashme;
- Përvojë në ndërtim kontenti, komunikime, menaxhim rrjetesh sociale;
- Njohje e platformave të kontentit dhe dizajnit si Canva, WordPress;
- Njohuri të mira të gjuhës Angleze;
- Të jetë person i përgjegjshëm, i përkushtuar në punë dhe proaktiv;
- Kreativ, i vëmendshëm ndaj detajeve dhe me aftësi të mira organizative.

Benefitet:

- **32-orë në javë punë;**
- **Kushte shumë të mira pune.**

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni aplikimin tuaj duke ndjekur linkun:

<https://aplikim.eppc.al>

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj do të kualifikohet.

Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.